VENDIM
Nr.555, datë 16.7.2004

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITI 2004, MIRATUAR PËR KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PËR FINANCIMIN E ZGJEDHJEVE TË PJESSHME PËR KRYETAR KOMUNE, NË KOMUNËN HUDENISHT, TË QARKUT TË KORÇËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë" dhe të neneve 7 e 10 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në buxhetin e miratuar për vitin 2004, t'i shtohet fondi prej 1 400 00) (një milion e katërqind mijë) lekësh, për financimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar komune, në komunën Hudenisht, të qarkut të Korçës, që u zhvilluan më datë 4.7.2004.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministri i Financave dhe kryetari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano